

**VENDIM**  
**Nr.438, datë 16.6.2005**

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË KOMUNËS LABINOT-FUSHË TË MJEDISEVE TË PRONËS “GRUP DEPO TË REPARTIT USHTARAK NR.8833”, NË MENGEL, ELBASAN, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mjediset e pronës “Grup depo të repartit ushtarak nr.8833, në Mengel të qarkut të Elbasanit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të kalojnë në pronësi të komunës Labinot-Fushë të qarkut të Elbasanit, për sistemimin e familjeve të prekura nga fatkeqësia natyrore në komunat Godoles, Griqan dhe Xibrakë.

2. Prona me numër rendor 316 “Grup depo të repartit ushtarak nr.8833” në Mengel të qarkut Elbasan, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Komunës Labinot-Fushë i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Labinot-Fushë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**